

PUSHIMI MJEKËSOR ME PAGESË: ÇFARË DUHET TË DINË PUNONJËSIT

Sipas Aktit për Earned Sick Time Act (Paid Sick Leave Law) (Kohën e Fituar të Pushimit Mjekësor në bashkinë e New York-ut (Ligjin mbi pagesën e pushimit mjekësor), punëtorët e siguar kanë të drejtën ta shfrytëzojnë pushimin mjekësor për tu trajtuar dhe për tu kujdesur për vetveten apo për ndonjë anëtar të familjes së tyre.

Department of Consumer Affairs (DCA) (Departamenti për Qështje të Konsumatorëve ka përgatitur) këtë fletushkë për t'i informuar punëtorët në lidhje me të drejtat që kanë sipas ligjit. DCA do t'i rifreskojë të dhënat sipas nevojës. Ju lutemi keni vëmendjen në datën që është shënuar në fund të kësaj fletushke. Për të lexuar ligjin dhe Pyetjet më të Shpeshta në lidhje me ligjin, shko ne faqen nyc.gov/PaidSickLeave.

PUNËTORËT TË MBULUAR / QË NUK JANË TË MBULUAR NGA LIGJI

Të Siguruarit	Të Pasiguruarit
<ul style="list-style-type: none"> Punëtorët me orar të plotë të punës Punëtorët me orar të pjesshme të punës Punëtorët me program për Punë Tranzicionale Punëtorët e padokumentuar Punëtorët që janë pjesëtar të familjes por jo pronarët Punëtorët të cilët jetojnë jashtë Qytetit të New York-ut <p>Punëtorët janë të obliguar të punojnë 80+ orë për 1 vit kalendarik në Qytetin e New York-ut.</p> <p>Shih seksionin “Punëtorët Vendorë” në anën e pasme të kësaj fletushke.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Punëtorët të cilët punojnë 80 orë apo më pak brenda 1 viti kalendarik në qytetin e New York-ut Studentët në programet federale për punë studiuuese Punëtorët puna e të cilëve kompenzohet nga programet e kualifikuara për bursa Punëtorët e agjensioneve qeveritare Terapistët fizik, therapistët profesional, patologistët e gjuhës dhe të folurit, audiologjistët të cilët janë të licensuar nga departamenti i Edukimit të Shtetit të New York-ut. <i>Këta profesionistë nuk janë të siguarar në bazë të këtij ligji nëse e caktojnë vetë orarin e tyre të punës, të cilët kanë mundësinë ta refuzojnë ose pranojnë shërbimin që iu referohet atyre, dhe të cilët paguhen me një pagë mesatare për një orë, e cila është së paku 4 herë sa minimumi i pagës federale</i> Kontraktorët e pavarur të cilët nuk i përkasin definicionit ose nuk i përmbushin kushtet të jenë punëtorë nën New York State Labor Law (Ligjin e Punës të Shtetit të New York-ut); (Shko tek faqja labor.ny.gov dhe kërko (“Independent Contractors” (“Kontraktorët e Pavarur.”)) Pjesëmarrësit në Programet për Eksperencë të Punës (WEP) Disa punëtorë të cilët janë pjesë të marrëveshjes së ujdive kolektive.

Shënim: Nëse punëdhënësi juaj ka një rregullore ekzistuese ku ju lejohet shfrytëzimi i pushimit mjekësor, atëherë ajo rregullore duhet të përmbush kushtet dhe të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara me ligj.

NJOFTIM PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Punëtori	Data e Shënuar e Njoftimit për Punëtorin
Punëtor i ri <i>I punësuar fillimisht me datë ose pas datës 1 Prill, 2014</i>	Dita e parë e punësimit
Punëtor ekzistues <i>Tashmë duke punuar për punëdhënësin para datës 1 Prill, 2014</i>	1 Maj, 2014

Nëse jeni i siguar nga punëdhënësi, punëdhënësi juaj është i obliguar të ju pajisë me një njoftim me shkrim në lidhje me të drejtat e tua për pushim mjekësor. Punëtorët kanë të drejtën për një njoftim të tillë të shkruar në gjuhën angleze, dhe, nëse është e disponueshme në webfaqen e DCA, edhe në gjuhën e tyre amtare. **Ruaje një kopje të një njoftimi të tillë.**

SASIA E PUSHIMIT MJEKËSOR (Shih “Punëtorët Vendorë”, seksioni prapa kësaj fletushke)

Numri i Punëtorëve të punësuar nga Punëdhënësi	Sasia e Pushimit Mjekësor për 1 vit kalendarik	Pushimi Mjekësor i Paguar ose i Papaguar	Norma e Pagesës
5 ose më shumë	Deri në 40 orë	Të paguara	Vlera e rregullt e pagesës, por jo më pak se \$8 për një orë (paga minimale)
1-4	Deri në 40 orë	Të papaguara	Nuk aplikohet

*Shënim: “Viti Kalendarik” nënkupton çdo periudhë kohore e rregullt dhe vijuese në kohëzgjatje prej 12-muajve e caktuar nga punëdhënësi.

DITËT E AKUMULUARA DHE ATO TË HARXHUARA TË PUSHIMIT MJEKËSOR – DATA TË RËNDËSISHME

(Shih “Punëtorët Vendorë” seksioni më poshtë, nëse është e aplikueshme)

Norma e kohës së grumbulluar	Data e fillimit	Data kur mund ta përdorni Pushimin Mjekësor
1 orë për çdo 30 orë të punuara	1 Prill, 2014 (Punëtori ekzistues)	30 Korrik, 2014 (Punëtori ekzistues)
	Dita e parë e punës (Punëtor i ri)	120 ditë pas ditës së parë të punësimit (Punëtor i ri)

Përfashtim: Nëse ndonjë punëtor është i mbuluar me marrëveshjen e ujdive kolektive që do të ishte në fuqi në datën 1 Prill, 2014, atëherë punëtori fillon ti grumbullojë ditët e pushimit mjekësor sipas Ligjit të Qytetit duke filluar nga data kur të mbaron marrëveshja e lartpërmendur.

Ruaje nga një kopje të çdo dokumenti të cilat tregojnë sasinë e orëve të pushimit mjekësor, kohës së akumuluar dhe asaj të shfrytëzuar.

ARSYET E PRANUARA QË MUNDËSOJNË SHFRYTËZIMIN E PUSHIMIT MJEKËSOR

Keni të drejtë të shfrytëzoni pushimin mjekësor nëse:

- Keni sëmundje fizike ose mentale, lëndime, apo ndonjë problem tjetër shëndetësorë; keni nevojë për një diagnozë mjekësore, keni nevojë për trajtim të ndonjë sëmundje fizike ose mentale, të ndonjë lëndimi apo gjendje tjetër shëndetësore; keni nevojë për preventivë mjekësore.
- Nëse jeni i detyruar të kujdeseni për ndonjë anëtar të familjes suaj që ka nevojë për ndonjë shërbim mjekësor dhe diagnozë medikale, për ndonjë përkujdesje apo trajtim të ndonjë sëmundje fizike apo mentale, të ndonjë lëndimi apo të një gjendje shëndetësore, apo që ka nevojë për ndonjë preventivë mjekësore.
- Nëse biznesi i punëdhënësit tuaj mbyllet për shkak të ndonjë emergjence të shëndetit publik, apo nëse keni nevojë të kujdeseni për ndonjë fëmijë tuajin, shkolla e të cilit, apo qendra e kujdesit shëndetësor, janë mbyllur për shkak të ndonjë emergjence të shëndetit publik.

Ligji i pranon si anëtarë të familjes personat siq vijon: Fëmijët, Nipat dhe Mbesat, Gruan, Partnerin Shtëpiak, Prindërit, Gjyshërit, Fëmijët apo Gjyshërit e një bashkëshorti të punëtorit apo partnerit shtëpiak; vëllezërit dhe motrat (duke përfshirë gjysmë vëllezërit dhe gjysmë motrat, të adoptuarit, si dhe motrat dhe vëllezërit nga njerku apo njerka).

NJOFTIM PARAPRAK

Nëse parashikohet ndonjë nevojë e arsyeshme, atëherë punëdhënësi juaj mund të kërkojë nga ju që të aplikoni për pushim mjekësor paraprakisht, me saktë 7 ditë para datës së fillimit të pushimit mjekësor. Por nëse paraqitet nevoja në mënyrë të pa parashikueshme, atëherë punëdhënësi juaj mund të kërkojë që të aplikoni për pushim mjekësor sa më shpejt që (është e arsyeshme). Punëdhënësi juaj mund të kërkojë nga ju që të siguroni vërtetim me shkrim ku do të verifikohet se ju e keni shfrytëzuar pushimin mjekësor për qëllime shëndetësore.

VËRTETIMI

Punëdhënësi juaj mund të kërkojë vërtetim nga shërbyesi i licensuar mjekësor nëse ju keni përdorë pushim mjekësor më shumë se tri ditë pune të njëpasnjëshme. Paid Sick Leave Law (Ligji mbi Pushimin Mjekësor me Pagesë) i ndalon punëdhënësit që të kërkojë nga shërbyesi mjekësor arsyen e ekzaminimit dhe gjendjen tuaj shëndetësore. Sidoqoftë, informata të tilla mund të kërkojnë në raste tjera të përcaktuara me ligj.

PUSHIMI MJEKËSOR I PAPËRDORUR

Ju mund ti bartni deri në 40 orë të pushimit mjekësor që nuk i keni shfrytëzuar në vitin pasues kalendarik. Sidoqoftë, punëdhënësi juaj është i obliguar të ju lejoj të shfrytëzoni vetëm 40 orë pushim mjekësor brenda një viti kalendarik.

KOMPENZIMI

Punëdhënësi juaj nuk guxon të kërkojë kompensim nga ju kundrejt kërkesës për pushim mjekësor. Kompensim ose shpajim përfshihet çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje të pozitës, suspendim, apo reduktim të orarit të punës, apo çdo akt tjetër në dëm tuajin në rastin kur tentoni apo shfrytëzoni të drejtën tuaj të garantuar me ligj.

ANKESAT

Ju mund të paraqitni ankesë tek DCA. Për të marrë formën e ankesës, shko tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave ose kontakto **311** (212-NEW-YORK jashtë NYC).

DCA do të bën një hetim dhe do të bashkëpunon me punëdhënësin për të zgjidhur ankesën tuaj. DCA do ta mban identitetin tënd konfidencial, dhe do ta bën publike vetëm në rast se një gjë e tillë është e domosdoshme për ti zhvilluar hetimet, nëse është e nevojshme për zgjidhjen e kontestit, ose nëse kjo gjë kërkohej nga ligji.

Punëtorët Vendorë

Më poshtë gjeni informatat në lidhje me sasinë e grumbulluar të orëve të pushimit mjekësor si dhe sasinë e orëve të shfrytëzuara të pushimit mjekësor, specifikisht vetëm për punëtorët vendor në bazë të Ligjit të Qytetit. Ky shfrytëzim i pushimit mjekësor është një kohë shtesë përveq të tri ditëve të pushimit të paguar për të cilën ju garanton Ligji i Punës i Shtetit të New York-ut. Shko tek faqja labor.ny.gov dhe kërko "Domestic Workers' Bill of Rights" ("Punëtorët Vendorë' Projektligji i të Drejtave.") Të gjitha informatat në këtë fletushkë janë të aplikueshme për ju.

Sasia e Pushimit Mjekësor per Vit Kalendarik	Të paguara ose të Papaguara	Norma e pagesës
2 ditë	1 paguar	Vlera e rregullt e pagesës, por jo më pak se \$8 për një orë (paga e tanishme minimale) Shko tek faqja labor.ny.gov dhe kërko "Minimum Wage" ("Paga Mesatare.")
Norma e kohës së akumuluar	Data e Fillimit	Data kur mund ta përdorni Pushimin Mjekësor
2 ditë pas 1 viti pune	DCA ju pajis me informata tek faqja nyc.gov/PaidSickLeave	DCA ju pajis me informata te nyc.gov/PaidSickLeave

PYETJE? Për të kontaktuar DCA, vizito nyc.gov/PaidSickLeave, email PaidSickLeave@dca.nyc.gov, ose thirr në **311** dhe kërko më shumë informata në lidhje me Pushimin Mjekësor me Pagesë.